



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Republika e Kosovës - Republika Kosov.
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 410/04-19375
Data/Datum 03. 09. 2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

KONTRATË

PËR

**DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËNS KOMUNALE –
TREGUT NË ROGOVË**

Gjakovë, 2020

Baza Juridike

Baza juridike për lidhjen e kësaj kontrate është e përcaktuar në dispozitat e nenit 5, 6, 8 dhe 14 pika 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 60 të Ligjit Nr.05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, Vendimit 01.Nr.011/11-21952, datës 03.06.2020, për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale-tregut në Rogovë, Njoftimit Publik 01Nr.463/02-14387 i datës 02.07.2020, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale, Rekomandimit të Komisionit Vlerësues të datës 19.08.2020.

Palët në këtë kontratë

1. **Komuna e Gjakovës**, të cilën e përfaqëson Ardian Gjini, Kryetar i Komunës, dhënësi i pronës komunale – Tregut në Rogovë me numër të njësisë kadastrale P707013071, (në vazhdim të tekstit: Komuna) dhe
2. **N.T.P “Vëllezërit Berisha”**, të cilën e përfaqëson Naser Berisha, me numër personal me numër të biznesit nga Gjakova, shfrytëzues i pronës komunale – Tregut në Rogovë me numër të njësisë kadastral P707013071, (në vazhdim të tekstit: Shfrytëzuesi).

Neni 1 Objekti i Kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim afatshkurtër nga Komuna dhe marrja në shfrytëzim afatshkurtër nga Shfrytëzuesi, pronën komunale – Tregun në Rogovë, me numër të njësisë kadastrale P707013071 zona kadastrale Rogovë, në pronësi të Komunës.

Neni 2 Kohëzgjatja e Shfrytëzimit

2.1. Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që prona komunale - Tregun në Rogovë sipas nenin 1 të kësaj kontrate të merret në shfrytëzim në kohëzgjatje prej 10 viteve, duke filluar nga data **01.09.2020 deri me 01.09.2030.**

2.2. Afati i shfrytëzimit nuk mund të zgjatet pa procedurë të re të njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

Neni 3 Vlera e Kompensimit për Shfrytëzimin

Palët janë pajtuar që për shfrytëzimin e pronës komunale – Tregut në Rogovë, që vlera e kompensimit për periudhën e cekur në nenin 2 të kësaj kontrate, është **620€**, në muaj. (gjashtëqind e njëzet euro)

Neni 4 **Mënyra dhe Afatet e Pagesës së Kompensimit**

- 4.1. Palë janë pajtuar që pagesa e shumës së kompensimit nga shfrytëzuesi, për shfrytëzimin e pronës komunale – Tregun në Rogovë i përcaktuar sipas nenit 3 të kësaj kontrate të bëhet në fillim të çdo muaji, por jo më larg se deri më datën **05** të muajit.
- 4.2. Shfrytëzuesi i pagesës së qirasë e bënë në ditë pune në xhirollogari të Komunës së Gjakovës me destinim: pagesa e kompensimit për shfrytëzimin e pronës komunale – Tregu në Rogovë.

Neni 5 **Dorëzimi i Pronës Komunale -Tregu në Rogovë në Shfrytëzim**

Komuna dhe Shfrytëzuesi janë pajtuar që dorëzim-pranimi i pronës komunale – Tregut në Rogovë të bëhet më së largu 10 ditë nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate, nga Komisioni i përcaktuar nga Komuna për Tregun në Rogovë në prani të Shfrytëzuesi, me procesverbal. Komisionit do të emërohet me vendim të veçantë.

Neni 6 **Destimi i Shfrytëzimit**

Prona komunale – Tregu në Rogovë sipas në nenin 2 të kësaj kontrate, nuk mund t'ia jep pronën në shfrytëzim nën-qira personave tjerë fizik dhe juridik, dhe nuk mund të jetë objekt i pengut (hipotekës) apo çfarëdo barre tjetër në raport me personat e tretë.

Neni 7 **Obligimet e Komunës**

1. Komuna në pajtim me këtë kontratë është e obliguar që t'i mundësoj pa pengesa, Shfrytëzuesit shfrytëzimin e pronës komunale – Tregun në Rogovë.
2. Komuna obligohet që të evidentoi shënimet përkatëse në librat e pronësisë për shfrytëzimin e pronës komunale – Tregun në Rogovë.

Neni 8 **Obligimet e Shfrytëzuesit**

- 8.1. Shfrytëzuesi në pajtim me këtë kontratë duhet t'i kryen këto obligime: Të bënë investimin në rregullimin e hapësirave të tregut; Të bënë mbjelljen e drunjtëve dekorativ rreth tregut; Vendorsjen e kontejnerëve për hedhjen e mbeturinave.
- 8.2. Shfrytëzuesi është i obliguar që t'i kryen të gjitha shërbimet e komunalive si ujë, rrymë mbeturinat etj, nga dita e marrjes në shfrytëzim.

Neni 9

Inspektimi

Komuna ka të drejtën të kontrollojë dhe të inspektojë pronën komunale – Tregun në Rogovë në çdo kohë, pa pasur kundërshtim nga shfrytëzuesi. Inspektimi ka për qëllim për të konstatuar gjendjen momentale të pronës komunale – Tregun në Rogovë gjatë kohës së shfrytëzimit nga ana e shfrytëzuesit.

Neni 10

Shkëputja e Kontratës me Marrëveshje

- 10.1. Palët kontraktuese në çdo kohë me marrëveshje mund të bëjnë shkëputjen e kësaj kontrate.
- 10.2. Para nënshkrimit të aktit mbi shkëputjen me marrëveshje të kontratës, palët rregullojnë në pajtim me ligjin çështjet lidhur me obligimet e mbetura.

Neni 11

Shkëputja e Njëanshme e Kontratës nga Komuna

Komuna rezervon të drejtën për shkëputje të kësaj kontrate në këto raste:

- 11.1. Kur Shfrytëzuesi i pronës komunale – tregut në Rogovë dështon të paguaj cilindo prej kësteve në shumën dhe afatin e përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate;
- 11.2. Nëse me dëshmi përkatëse të mbikëqyrjes inspektive konstatohet se Shfrytëzuesi nuk e shfrytëzon pronën komunale – Tregun në Rogovë në pajtim me destinimin e cekur në nenin 9 të kësaj kontrate;
- 11.3. Nëse me dëshmi të mbikëqyrjes inspektive konstatohet se ka bërë ndërrime të strukturës së tregut dhe ndërtime të reja brenda dhe jashtë hapësirës së tregut.

Neni 13

Shkëputja e Njëanshme e Kontratës nga Shfrytëzuesi

1. Shfrytëzuesi do të shkëput kontratën në mënyrë të njëanshme nëse Komuna nuk përmbush obligimet e përcaktuara në nenin 7 të kësaj kontrate.
2. Me heqjen dorë të Shfrytëzuesi, nga shfrytëzimi i mëtejshëm të pronës komunale – Tregut në Rogovë, duhet të njoftohet me shkrim Komuna në afat prej 3 muajve para kohës për të cilën shfrytëzuesi nuk dëshiron të shfrytëzoj tregun afarist.

Neni 14
Zbatimi i kontratës

Për zbatimin në tërësi të kësaj kontrate do të kujdeset, Kryetari i Komunës duke e autorizuar Komisioni përgjegjës me vendim të veçante.

Hyrja në Fuqi

1. Kjo kontratë është përpiluar në katër (4) ekzemplarë autentik dhe përbënë pesë (5) faqe e cila pas leximit nga kontraktuesit është nënshkruar pa vërejtje.
2. Me kopje të kësaj kontrate përveç shfrytëzuesit do të njoftohet edhe Qiramarrësit do të njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtorin për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Punë Inspektuese dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Prone.
3. Kjo kontratë hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët.

P A L Ë T

Kryetari i Komunës së Gjakovës

Ardian Gjini



N.T.P "Vëllezërit Berisha"

Naser Berisha